



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2020:041587
Datë: 25.09.2024
Numri i dokumentit: 06205024

Rev.nr.380/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Zenel Leku, kryetar, Rrustem Thaqi dhe Nenad Lazic, anëtar, në çështjen juridike kontestimore të paditëses R. G., nga Fushë Kosova, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Shpëtim Sadiku, avokat nga Lipjani, kundër të paditurës L.K., International Airport J.S.C. me seli në V., të cilën e përfaqësojnë sipas autorizimit Shkëlzen Sopjani avokat nga Fushë Kosova dhe L.F., përfaqësuese, me objekt kontesti anulimi vendimi, kthim në punë dhe kompensimi i pagave, duke vendosur sipas revizionit të autorizuarit të paditëses, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.6273/2021 të datës 22.05.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 23.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet i pathemeltë revizioni i të autorizuarit të paditëses R. G., nga F.K., i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.6273/2021 të datës 22.05.2024.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan, C.nr.460/20 të datës 21.04.2021, në pikën I të dispozitivit është aprovuar kërkesëpadia e paditëses R.G., nga F. K., si e bazuar dhe është anuluar njoftimi-vendimi i të paditurës L.K., International Airport J.S.C. me seli në V., për mosripërritje të kontratës së punës, i datës 31.01.2020 për paditësen, që në afat prej 7 ditësh nga dorëzimi i aktgjykimit, paditësen ta kthejë në punë dhe detyra të punës “Pastrues

të terminalit dhe ndërtesave (Terminal building and cleaning)", si dhe brenda të njëjtit afat t'ia shpërblejë paditëses dëmin material për shkak të mos realizimit të ardhurave personale, për periudhën kohore prej datës 01.02.2020 e deri më datë 09.11.2020 dhe atë për paga neto në shumë prej 2,135.10 € me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke filluar nga data e nxjerrjes së ekspertizës financiare, datë 09.11.2020 e deri tek pagesa definitive, si dhe në të ardhmen për çdo muaj në emër të pagës bruto shumë prej 248.00 €, nga data 09.11.2020 e deri në kthimin e paditëses në punë dhe detyra të punës si më lartë dhe detyrohet e paditura L.K., International Airport J.S.C. me seli në V., që paditëses R. G., nga F.K., t'ia bëjë transferin e mjeteve në TKPK - Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës, në llogarinë bankare:në shumë prej 115.32 €, në emër të tatimit në burim në llogari të ATK-së, shumë prej 55.98 €, si dhe në emër të kamatës së arritshme shumë prej 14.23 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim. Në pikën II të dispozitivit detyrohet e paditura që paditëses t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 1014 €, në afat prej 7 dite nga dita e marrjes në dorëzim të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim.

Gjykata e Apelit të Kosovës, duke vendosur sipas ankesës të autorizuarit të paditurës, me aktgjykimin Ac.nr.6273/2021 të datës 22.05.2024, në pikën I të dispozitivit ka aprovuar të themeltë ankesën e të paditurës Aeroporti Ndërkombëtar "L. K", I, A., J.S.C, me seli në V., Komuna L., ndërsa ka vendosur që aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan, C.nr.460/20 i datës 21.04.2021 të ndryshohet, ashtu që tani gjykohet si në vijim: refuzohet kërkesëpadia e paditëses R.G., nga F.K., me të cilën ka kërkuar që të anulohet në tërësi njoftimi i të paditurës Aeroporti Ndërkombëtar "L.K", I, A., J.S.C, me seli në V., Komuna L., për mosripëtrirjen e kontratës së punës të datës 31.01.2020 për paditësen, si dhe të detyrohet e paditura në afat prej 7 ditësh nga dorëzimi i aktgjykimit, paditësen ta kthejë në punë dhe detyra të punës "Pastrues të Terminalit dhe Ndërtesave (Terminal Building and Cleaning)", si dhe brenda të njëjtit afat t'ia shpërblejë paditëses dëmin material për shkak të mos realizimit të të ardhurave personale, për periudhën kohore prej datës 01.02.2020 e deri më datë 09.11.2020 dhe atë për paga neto në shumë prej 2,135.10 €, me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke filluar nga data e nxjerrjes së ekspertizës financiare, datë 09.11.2020 e deri tek pagesa definitive, si dhe në të ardhmen për çdo muaj në emër të pagës bruto shumë prej 248.00 €, nga data 09.11.2020 e deri në kthimin e paditëses në punë dhe detyra të punës si më lartë dhe e ka detyruar të paditurën L.K., I, A., J.S.C. me seli në V., që paditëses R. G., nga F.K., t'ia bëjë transferin e mjeteve në TKPK - Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës, në llogarinë bankare:në shumë prej 115.32 €, në emër të tatimit në burim në llogari të ATK-së, shumë prej 55.98 €, si

dhe në emër të kamatës së arritshme shumë prej 14.23 € dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 1014 €, në afat prej 7 dite nga dita e marrjes në dorëzim të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim, në tërësi di e pabazuar. Në pikën II të dispozitivit është vendosur që secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë i autorizuari i paditëses, në afat ligjor ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të ndryshoj aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, ashtu që të vërtetoj aktgjykimin e shkallës së parë.

Pala e paditur me përgjigje në revizion ka kërkuar që Gjykata Supreme e Kosovës revizionin e paditëses ta refuzoj në tërësi, ndërsa aktgjykimin e shkallës së dytë ta vërtetojë.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se:

Revizioni i të autorizuarit të paditëses është i pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune te e paditura në pozitën "T & B C", dhe atë sipas kontratës në kohë të caktuar, për periudhën nga data 03.04.2018 e deri më datë 31.01.2020, ndërsa kjo marrëdhënie e punës ka vazhduar me aneks kontrata deri më datë 31.01.2020 kur e paditura me vendimin me shkrim të datës 31.01.2020 e ka njoftuar paditësen se nuk do ti vazhdohet kontrata e punës te e paditura. Paditësja duke pretenduar se i janë shkelur të drejtat nga marrëdhënia e punës më datë 13.03.2020 në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurës, me të cilën ka kërkuar të anulohet vendimi i të paditurës për mos vazhdimin e kontratës së punës, të kthehet në punë dhe detyra të punës dhe t'ia kompensoj të ardhurat personale.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, si dhe vlerësimit të gjitha shkresave tjera të lëndës ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses, me vlerësim se mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësja ka punuar tek e paditura nga data 03.04.2018 e deri më datë 31.01.2020, në pozitën e punës "T., & B C", kur i është dorëzuar vendimi me shkrim më datë 31.01.2020, për mosripërtitjen e kontratës së punës. Nuk ka qenë kontestues fakti se ndaj paditëses nuk është zhilluar asnjëherë procedurë disiplinore, apo ndonjë procedurë e brendshme në lidhje me ndërprerjen e kontratës së punës, respektivisht të marrdhënies së punës. Kontestuese ndërmjet palëve ndërgjyqëse ishte çështja e ligjshmërisë së vendimit të të paditurës për

shkëputjen e kontratës së punës paditëses, çështja se e paditura këtë vendim a e ka marrë në përputhje me dispozitat ligjore të parapara me Ligjin e Punës. Kundër njoftim-vendimit për mosripërtëritje të kontratës së punës, paditësja më datë 07.02.2020 ka paraqitur ankesë, për të cilën ankesë Bordi i Ankesave ka ardhur në përfundim se është e pabazuar, kurse vendimi për mosripërtëritje të kontratës së punës i datës 31.01.2020 është vërtetuar si i drejtë dhe i bazuar në Ligjin e Punës.

Gjykata e shkallës së parë ka shtuar se mbi bazën e provave të administruara, e bazuar në dispozitat e Ligjit të Punës, LMD-së dhe Ligjit për Greva, ka ardhur në përfundim se vendimi për mosripërtëritje të kontratës së punës është i kundërligjshëm, pasi që ky vendim është marrë në kundërshtim me nenin 4 të LMD-së, pasi që vendi i punës në të cilin ka punuar paditësja te e paditura, që nga momenti i themelimit të marrëdhënies së punës, në bazë të kontratës së punës me afat të caktuar, e datës 03.04.2018, ka qenë vend i përhershëm pune, e cila kontratë është vazhduar me 8 aneks kontrata, e të cilat kontrata i janë vazhduar deri më datë 31.01.2020, andaj me këto kontrata dhe aneks kontrata për vazhdimin e punës në kohë të caktuar është shkelur parimi i ndërgjegjshmërisë dhe ndershmërisë, duke e mbajtur paditësen e paditura në një gjendje të pasigurt juridike të marrëdhënies së punës, që nga data 03.04.2018 e deri me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës më datë 31.01.2020.

Gjykata e shkallës së parë më tej ka theksuar se bazueshmërinë e kërkesëpadisë e ka mbështetur në nenin 5.1 të Ligjit të Punës, ku përcaktohet se është i ndaluar çfarëdo diskriminimi në punësim, profesion, lidhur me rekrutimin në punësim, trajnimin, promovimin e punësimit, kushtet e punësimit, masa disiplinore, ndërprerja e kontratës së punës ose çështjeve tjera nga marrëdhënia e punës të rregulluara me këtë ligj dhe ligjet tjera në fuqi, dhe mbi këtë bazë e paditura ka dështuar për të vërtetuar faktin se i është përmbajtur ndalimit të diskriminimit.

Me vendimin për mosripërtëritjen e kontratës së punës, kjo gjykatë ka vlerësuar se është cënuar dispozita e nenit 13 të Ligjit për Greva, ngase e paditura qysh nga koha e mbajtjes së grevave të punëtorëve të të paditurës më datë 21.08.2019, ka mbajtur trajnime me punëtor të rinj dhe prej mbajtjes së grevave të punëtorëve e deri në kohën e mosripërtëritjes së kontratës së punës paditëses, ka pranuar 66 punëtorë të rinj. Po në këtë periudhë paditëses së bashku me 23 punëtorë të tjerë të punësuar tek e paditura nuk i është vazhduar kontrata e punës, ndërsa tre të tjerëve i është ndërprerë kontrata e punës, fakt ky i cili vërtetohet se paditëses nuk i është vazhduar kontrata e punës vetëm se e njëjta ka qenë njëra prej pjesëmarrëseve në grevën e organizuar nga SH.S.P, më datë 19, 20 dhe 21.08.2019.

Gjykata vlerëson se e paditura me rastin e mosripërtëritjes së kontratës së punës paditëses, me vendimin e datës 31.01.2020 dhe përgjigjen në ankesë të datës 20.02.2020, nuk i ka respektuar dispozitat ligjore të parapara me Ligjin e Punës dhe Marrëveshjen Kolektive, si dhe të njëjtat vendime-përgjigje janë marrë në kundërshtim me këtë ligj. Kjo është vërtetuar edhe nga vendimi i Inspektoriatit të Punës së shkallës së parë, me nr. Nr.Rap 01-14-66/2020-1 i datës 02.04.2020, me të cilin janë anuluar vendimet për mosvazhdimet e kontratës së punës së punëtorëve të tjerë dhe paditëses, dhe vendimit të IP-së të shkallës së dytë me nr. 386/2020 të datës 06.08.2020, me të cilin vendim, ankesa e të paditurës është refuzuar si e pabazuar dhe vendimi i shkallës së parë i Inspektoriatit të Punës është vërtetuar.

Gjykata e Apelit duke vendosur lidhur me ankesën e palës së paditur nuk e ka pranuar qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë duke vlerësuar se është aplikuar gabimisht e drejta materiale bazuar në gjendjen faktike të konstatuar. Gjykata ankimore me anë të vlerësimit ndryshe të shkresave dhe provave të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit kryesor nga gjykata e shkallës së parë, konstaton një gjendje tjetër faktike, nga ajo e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, mbi bazën e së cilës gjendje faktike kjo gjykatë vjen në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është tërësisht e pabazuar, për çka aktgjykimi i atakuar është ndryshuar dhe është refuzuar kërkesëpadia e paditëses.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit në rastin konkret, e bazuar në provat e administruara që gjenden në shkresat e lëndës, gjeti se e paditura nuk ia ka ndërprerë në mënyrë të kundërligjshme marrëdhënien e punës paditëses, ashtu siç ka konstatuar gjykata e shkallës së parë. Paditësja me të paditurën kanë lidhur kontratë të punës në afat të caktuar ashtu nga data 03.04.2018 deri me datë 31.07.2018, pastaj e vazhduar në kohë të caktuar deri më datë 31.01.2020. Kjo gjykatë ka vlerësuar se në rastet kur kemi kontratë të punës në kohë të caktuar atëherë vjen në shprehje një situatë krejt tjetër përkundër rasteve kur kontrata e punës konsiderohet në kohë të pa caktuar. Tek kontratat me periudhë të caktuar nuk kërkohet arsye për ndërprerje të marrëdhënie së punës, për arsye se palët janë të vetëdijshme se marrëdhënia e punës do të ndërpritet me kalimin e asaj periudhe të caktuar kohore të cekur në kontratën e punës. Në rastin konkret, vazhdimi i kontratës së punës do të vinte në shprehje vetëm po që se e paditura do të kishte vullnet që të vazhdojë marrëdhënien e punës.

Gjykata e Apelit ka theksuar se në këtë rast nuk ka pasur nevojë që të zhvillohet asnjë procedurë disiplinore, e as e paditura nuk ka qenë e detyruar që të zhvillojë procedurë të tillë e as të japë arsye lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies së punës, sepse siç u cek edhe më lartë kontrata ka

qenë e lidhur në kohë të caktuar, ashtu që rrjedhimisht paditësja veç se ka qenë e vetëdijshme se marrëdhënia e punës mund të mos vazhdohet pas kësaj periudhe. Pra e paditura nuk e ka ndërprerë në mënyrë të kundërligjshme marrëdhënien e punës, siç ka konstatuar gjykata e shkallës së parë, kjo pasi që paditësja me të paditurën kanë lidhur kontratë të punës në afat të caktuar, ashtu që kjo kontratë është vazhduar nga data 03.04.2018 deri më datë 31.01.2020 dhe në rastet kur kemi kontratë të punës në kohë të caktuar atëherë vjen në shprehje një situatë krejt tjetër përkundër rasteve kur kontrata e punës konsiderohet në kohë të pacaktuar. Tek kontratat me periudhë të caktuar nuk kërkohet arsye për ndërprerje të marrëdhënie së punës, për arsye se palët janë të vetëdijshme se marrëdhënia e punës do të ndërpritet me kalimin e asaj periudhe të caktuar kohore të cekur në kontratën e punës. Sa i përket kompensimit të një page, pasi që e paditura nuk e ka njoftuar paditësen se nuk ka qëllim të ia ripërtërijë kontratën e punës me kohë të caktuar, e paraparë me nenin 72 paragrafi 3 i Ligjit të Punës, kjo gjykatë vlerëson se e paditura me vendimin për mosripërtirjen e kontratës së punës e ka njoftuar paditësen se konform këtij neni do t'i paguhen të gjitha detyrimet financiare që e paditura ka ndaj paditëses, e ndërsa kjo nuk ka qenë kontestuese nga palët ndërgjyqëse.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e dhënë në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, pasi që aktgjykimi i kundërshtuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat gjykata e revizionit në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Përfaqësuesi i paditëses në revizionin e paraqitur për nga baza i është referuar shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, mirëpo në arsyetim të revizionit nuk ka përmendur shprehimisht ndonjë dispozitë ligjore apo ndonjë arsye për ndonjë shkelje procedurale, prandaj Gjykata Supreme sa i përket kësaj baze është kufizuar vetëm në shkeljet që shikohen sipas detyrës zyrtare në përputhje me dispozitën e nenit 215 të LPK-së.

Gjykata Supreme e Kosovës e ka pranuar qëndrimin e gjykatës së shkallës së dytë për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale, kjo nisur nga fakti se marrëdhënia e punës së paditëses te e paditura ka qenë në kohë të caktuar dhe palët mes veti kanë përcaktuar kohëzgjatjen e kontratës, përkatësisht janë marrë vesh se cili është statusi i paditëses te e paditura dhe me asnjë provë nuk është arritur të vërtetohet se paditësja te e paditura ka mbërritur periudhën kohore për tu trajtuar marrëdhënia e saj e punës si marrëdhënie në kohë të pacaktuar, ashtu siç është përcaktuar me nenin 10, paragrafi 5 të Ligjit të Punës.

Në këtë rast marrë për bazë faktin që marrëdhënia e punës ka qenë në kohë të caktuar, e paditura obligimin e vetëm e ka pasur që paditësen një muaj përpara ta njoftoj se nuk do ti vazhdohet kontrata e punës, e cila është parapa që të skadojë në kohën e caktuar. Ligji i Punës me nenin 67 ka përcaktuar ndërprerjen e kontratës së punës sipas fuqisë ligjore dhe një nga format është skadimi i kohëzgjatjes së kontratës, gjë që në këtë rast në raport me paditësen është plotësuar ky kusht ligjor, mirëpo obligimi i vetëm i punëdhënësit në këtë rast është që ta lajmëroj një muaj më herët punëtorin.

Nëse kontrata e punës është lidhur për kohë të caktuar, ndërsa nuk plotësohen kushtet ligjore që kontrata e punës të trajtohet në kohë të pacaktuar, njoftimi për mos vazhdim të kontratës së punës nuk mund të trajtohet në aspektin e kundërligjshmërisë dhe aspektin e dhënies së arsyeve për mos vazhdim të kontratës së punës. Kjo pasi që në këto raste është në vullnetin e punëdhënësit të vendos që të vazhdoj apo jo marrëdhënien e punës, ndërsa punëdhënësi mundet që mos ta njoftoj punëtorin për mos vazhdim të kontratës së punës dhe pasoja e vetme për të do të jetë pagimi i një page shtesë, ashtu siç është përcaktuar me nenin 71 paragrafi 2 të Ligjit të Punës.

Situata do të ishte ndryshe sikur paditësja të e paditura të ishte në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar, apo të plotësoheshin kushtet ligjore për tu konsideruar se kontrata e punës është në kohë të pacaktuar, kjo pasi që në këtë rast njoftimi për mos vazhdim të marrëdhënies së punës do duhej të trajtohet në aspektin e shkaqeve që kanë quar deri te ndërprerja e marrëdhënies së punës dhe procedura që është ndjekur nga ana e punëdhënësit.

Në praktikën gjyqësore ka pasur dilema dhe vendimmarrje ndryshe, në veçanti në gjykatat e instancave më të ulëta, si në gjykatën e shkallës së parë ashtu edhe në gjykatën e shkallës së dytë, në lidhje me interpretimin e nenit 10 paragrafi 5 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, me të cilin përcaktohet se: *“Kontrata e Punës, për një periudhë të caktuar, që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme, për një periudhë të punësimit më të gjatë se tri (3) vite, do të konsiderohet si kontratë e lidhur në kohë të pacaktuar, mirëpo sipas Gjykatës Supreme këto nuk janë me ndikim për vendimmarrje ndryshe në këtë rast, për arsye se secili vendim gjyqësor me të cilin përfundon procedura kontestimore mund ti nënshtrohet kontrollit të ligjshmërisë sipas mjeteve të goditjes të rregullta dhe të jashtëzakonshme ashtu siç është përcaktuar me dispozitat ligjore të LPK-së. Ndërsa është fakt jokontestues se praktika gjyqësore si burim i së drejtës mund të përdoret vetëm kur ajo është krijuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, si e vetmja gjykatë kompetente në bazë të Ligjit për Gjykatat, për krijimin e praktikës gjyqësore, si me qëndrime parimore, mendime juridike dhe udhëzues juridik, ashtu edhe me*

vendime gjatë vendosjes sipas mjeteve të jashtëzakonshme. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, me vendimet e saj është qartësuar se Kontrata e Punës, për një periudhë të caktuar, që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme, për një periudhë të punësimit më të gjatë se dhjetë (10) vite, do të konsiderohet si kontratë e lidhur në kohë të pacaktuar.

Si përfundim, Gjykata Supreme vlerëson se marrëdhënia e punës së paditëses te e paditura ka qenë në kohë të caktuar, ashtu siç palët janë marrë vesh me kontratë dhe anekset e kontratës, pala e paditur ka ndërmarrë hapat e duhur ligjor për të njoftuar paditësen se nuk do i vazhdoj kontratën e punës, ndërsa nuk ka asnjë bazë ligjore që kontrata e punës e paditëses te e paditura të trajtohet në kohë të pacaktuar, andaj janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 67, paragrafi 1, pika 1.3 të Ligjit të Punës, që kontrata e punës është ndërprerë sipas fuqisë ligjore për shkak të skadimit të kohëzgjatjes së kontratës dhe rrjedhimisht për palën e paditur nuk lind asnjë obligim, ashtu siç me të drejtë ka vendosur në këtë rast gjykata e shkallës së dytë.

Gjykata Supreme e Kosovës me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas revizionit të paraqitur, mirëpo ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, për çka edhe ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe në pajtim me nenin 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.380/2024, më 23.09.2024

Kryetari i Kolegjit - Gjyqtari

Zenel Leku